



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

KOMUNA E PRISHTINËS
KRYETARI I KOMUNËS



Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/04, qershor 2008), nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës merr këtë

V E N D I M

PER PLOTESIMIN DHE NDRYSHIMIN E VENDIMIT

- I. MIRATOHET Vendimi për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit 14-020/07-0052287/22 i dt. 09.03.2022, për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve në fushën e mirëqenies sociale, për rastet e varfërisë së skajshme të individit apo familjes, të fatkeqësive natyrore, të sëmundjeve të rënda kronike, të familjeve me përkujdesje të fëmijëve me çrregullime të përhershme shëndetësore, me fëmijë dhe personat e moshës madhore të cilët janë persona me aftësi të kufizuara si dhe për pagesë të qirasë.
- II. Sipas pikës I të këtij Vendimi, plotësim ndryshimi nënkupton caktimin e një anëtari rezervë, ku si anëtar rezervë caktohet z. Hasan Mustafa “Kryqi i Kuq” dega në Prishtinë dhe zëvendësimin e anëtares Shpresa Kuqi, ku në vend të saj caktohet Dr. Valdet Hashani.
- III. Për kryerjen e këtyre detyrave të cekura në pikën III të këtij vendimi, komisioni i raporton Kryetarit të Komunës.
- IV. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet Vendimi nr. 14-020/04-181845/22 i dt. 29.07.2022.
- V. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

U dorëzohet:

- Shpresa Kuqi,
- Dr. Valdet Hashani,
- Qendrës për shërbim me qytetarë,
- Në dosje.

KRYETARI I KOMUNËS
Përparim Rama

